



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Raporti i Diskutimit Publik për projekt Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

Bazuar në Vendimin nr.01-550/02-0022469/21, të datës 10 mars 2021 mbi vënien në diskutim publik të projekt Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në territorin e Komunës së Podujevës.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim të Komunës së Podujevës, duke u bazuar në Ligjin nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ka informuar qytetarët përmes njoftimit publik mbi mundësinë e parashtrimit të propozimeve, sugjerimeve apo vërejtjeve eventuale prej datës 15 mars 2021 deri me datë 15 prill 2021, të cilat mund të paraqiten në formë të shkruar në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim si dhe në dy adresat elektronike të publikuara në këtë Vendim.

Dita e debati publik për dokumentin në fjalë është mbajtur me 23 mars 2021 ashtu siç ka qenë e përcaktuar në vendimin për vënien në diskutim publik.

Në këtë debat kanë qenë të pranishëm 20 qytetarë të Komunës së Podujevës duke përfshirë edhe përfaqësues të KFOR-it, me ç'rast shfaqën falënderime dhe mirënjohje për transparencën komunale si dhe u informuan në tërësi për projekt Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në territorin e Komunës së Podujevës.

Për projekt Rregulloren në fjalë nuk është paraqitur asnjë vërejtje apo sygjërim nga ana e të pranishmëve.

Po ashtu gjatë periudhës së debatit publik në e-mailat e zyrtarëve të autorizuar nuk ka arritur asnjë vërejtje, propozim apo sugjerim nga ana e qytetarëve dhe subjekteve të tjera.

Bashkangjitur këtij raporti gjeni:

Projekt Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në territorin e Komunës së Podujevës.



Drejtori i DSHMS-së
Dr. Driton VELIU



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

PROCESVERBAL

Nga takimi i mbajtur më 23 mars 2021

Mbledhja filloi në orën 10:00 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objektin e ri të Komunës. Takimin e hapi dhe kryesoi z.Driton Veliu drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin qytetarë të Komunës së Podujevës, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë.

Tema: Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

z.Driton Veliu drejtor i DSHMS theksoi, ne këtu para jush kemi paraqitur një propozim rregullore të re e cila është hartuar nga OJQ ATRC në bashkëpunim me organet përkatëse të nivelit qendror si model për të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës në mënyrë që të miratohet nga kuvendet e komunave pas vendosjes së specifikave përkatëse. Kjo propozim rregullore ka një volum të madh të përmbajtjes prej 21 faqeve ne në pika të shkurtra do t'i përcaktojmë disa nga pikat më të rëndësishme të saj si dispozita e përgjithshme qëllimi fushëveprimin dhe mekanizmat e kësaj projekt rregulloreje. Qëllimi i kësaj projekt rregulloreje është që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe kompetencat vetanake të Komunës së Podujevës. Ku përfshihet mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike mendore, abuzimit, keqpërdorimit shfrytëzimit, neglizhimin që vë në rrezik, jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Kjo rregullore gjithashtu ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të subjekteve për mbrojtjen e fëmijës si dhe mënyrës së koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me qellim të kontributit në sistemin për mbrojtjen e fëmijës. Rëndësia e kësaj rregulloreje është se parasheh kontributin e një Komune mike për fëmijët. Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është të zbatohen ligjet dhe rregulloret për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fazat, për të gjitha masat për veprimet dhe mos veprimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës në Komunën e Podujevës në përputhje me obligimet e dala nga ligji për mbrojtjen e fëmijës. Kjo rregullore zbatohet për fëmijët me shtetësi Kosovare por edhe për ata fëmijë pa shtetësi të pa regjistruar për azil kërkuesit, refugjatët ose me shtetësi të huaj brenda territorit të Komunës së Podujevës. Dispozita e kësaj rregulloreje nuk mund të merret si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me këtë rregullore të re ne kemi avancim të drejtave të fëmijës. Ne i kemi certifikuar mekanizmat Komunal për mbrojtje të fëmijës ku me anë të kësaj rregulloreje mekanizma për mbrojtje të fëmijës janë: Kryetari i Komunës, drejtoritë dhe njësitë përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, QPS, ekipet për mbrojtjen e

fëmijës, njësia për mbrojtjen e fëmijës, institucione shëndetësore, institucionet arsimore publike dhe publike për mbrojtjen e fëmijës organizata e shoqërisë civile, familjet strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës dhe subjektet tjera që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës sipas legjislacionit në fuqi.

Meqë nuk pati persona tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën për të parashtruar pyetje sugjerime apo ndonjë plotësimdryshim rreth dokumentit në fjalë, Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Takimi përfundoi në orën 10:20

Procesverbalin e mbajti

Osman Bajrami



Podujevë, 23 mars



Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë

dhe Mirëqenies Sociale

Dr. Driton Veliu

